



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 02/04-19819 dt. 01/06/ 2026



Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 53, 57 dhe 58 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe Shkresës së Ministrisë së Administrimit të pushtetit Lokal Nr.020-236/6 të datës 04.05.2026. Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2026 miratoi këtë:

V E N D I M

Për Shfuqizimin e vendimit 02 Nr.462/01-11329 për themelimin e komisionit për shqyrtimin e listës së veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale dhe ofrimin e rekomandimeve të veta për pronat ndaj të cilave mund të iniciohen procedurat e dhënies në shfrytëzim përmes negocimit apo shpalljes publike

Neni 1

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.05.2026 dhe legjislacionin në fuqi si dhe Shkresës së Ministrisë së Administrimit të pushtetit Lokal Nr.020-236/6 të datës 04.05.2026 miraton vendimin për Shfuqizimin e vendimit 02 Nr.462/01-11329 për themelimin e komisionit për shqyrtimin e listës së veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale dhe ofrimin e rekomandimeve të veta për pronat ndaj të cilave mund të iniciohen procedurat e dhënies në shfrytëzim përmes negocimit apo shpalljes publike

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi janë përgjegjëse Kuvendi Komunal dhe Zyra e Kryetarit.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryetari i Kuvendit Komunal

Burim Bujupi

ARSYETIM

Komuna e Drenasit në harmoni me legjislacionin në fuqi i cili e rregullon këtë fushë ka filluar procedurat për Themelimin e komisionit për shqyrtimin e listës së veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale dhe ofrimin e rekomandimeve të veta për pronat ndaj të cilave mund të iniciohen procedurat e dhënies në shfrytëzim përmes negocimit apo shpalljes publike, si rrjedhojë e të cilit proces është edhe miratimi i të njëjtit vendim. Kuvendi komunal me datë 30.03.2026 miraton vendimin për themelimin e komisionit në fjalë dhe të njëjtën me datë 31.03.2026 e parashtrohet për shqyrtim të ligjshmërisë në MAPL.

Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal përmes aktit të saj *Nr.020-236/6 të datës 04.05.2026* konstaton se akti në fjalë është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si të tillë e kundërshton ecjen tutje të këtij projekt akti. Në arsyetimin e saj konstaton se vendimi 02 Nr.462/01-11329 për themelimin e komisionit për shqyrtimin e listës së veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale dhe ofrimin e rekomandimeve të veta për pronat ndaj të cilave mund të iniciohen procedurat e dhënies në shfrytëzim përmes negocimit apo shpalljes publike nuk parashihet me Ligjin Nr.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Duke marrë parasysh një situatë të tillë Kryetari i Komunës përmes këtij vendimi i propozon Kuvendit të Komunës që duke marrë parasysh legjislacionin në fuqi dhe konstatimet e bëra nga Ministria gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së këtij akti të votohet ky propozim vendim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit
Kopje:	Burim Bujupi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit
Përmes:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Erbilin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor MAPL
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve Komunale
Lënda:	Konfirmim i Ligjshmërisë
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimin 02Nr.020/04-19819 për shfuqizimin e Vendimit 02Nr.462/01-11329 për themelimin e komisionit për shqyrtimin e listës së veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale dhe ofrimin e rekomandimeve të veta për pronat ndaj të cilave mund të iniciohen procedurat e dhënies në shfrytëzim përmes negocimit apo shpalljes publike

I miratuar më datë: 29.05.2026

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 09.06.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2026, ka miratuar Vendimin 02Nr.020/04-19819 për shfuqizimin e Vendimit 02Nr.462/01-11329 për themelimin e komisionit për shqyrtimin e listës së veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale dhe ofrimin e rekomandimeve të veta për pronat ndaj të cilave mund të iniciohen procedurat e dhënies në shfrytëzim përmes negocimit apo shpalljes publike.

MAPL, konstaton se akti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, është bazuar në nenet 11, 12 dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenin 34 të Statutit të Komunës së Glllogocit, nenet 53, 57 dhe 58 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative si dhe në Shkresën e Ministrisë së Administrimit të pushtetit LokalNr.020-236/6 të datës 04.05.2026.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e mbajtur të datës 29.05.2026, me 22 vota për, 0 kundër dhe 1 abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.